



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**RREGULLORE  
MBI ORGANIZIMIN E VEPRIMTARISË KËRKIMORE NË  
AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE**

*Miratuar me vendim Bordi nr. 177, datë 13.12.2011*

*Ndryshuar me vendim Bordi nr. 98, datë 18.7.2012*

*Ndryshuar me vendim Bordi nr. 152, datë 30.11.2017*

## **KAPITULLI I**

### **TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

##### **Objekti i Rregullores**

Kjo Rregullore ka për objekt të përcaktojë normat e përgjithshme që rregullojnë organizimin e veprimtarisë kërkimore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (në vijim referuar si Autoriteti), detyrat funksionale të përgjithshme dhe të veçanta të çdo individi dhe njësie që angazhohet në këtë veprimtari.

#### **Neni 2**

##### **Baza Ligjore**

Kjo Rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 9, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”; nenit 22 dhe nenit 24 / a të “Rregullave të brendshme të Autoritetit” miratuar me vendimin e Bordit nr. 7, datë 30.08.2007

#### **Neni 3**

##### **Fusha e veprimtarisë**

Veprimtaria e punës kërkimore në Autoritet i shërben plotësimit të funksioneve dhe realizimit të detyrave të Autoritetit për rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë në fushën e sigurimeve, titujve, të pensioneve vullnetare private, veprimtari të tjera financiare jo-bankare dhe zhvillimit e konsolidimit të vetë Autoritetit.

#### **Neni 4**

##### **Produkti kërkimor**

Kërkimi është një funksion kryesor në Autoritet. Produkti kërkimor materializohet në dy forma kryesore: (i) Materiali i Diskutimit dhe (ii) Artikulli.

#### **Neni 5**

##### **Angazhimi në veprimtarinë kërkimore**

Nisur nga kompleksiteti i çështjeve që lidhen me institucionet, tregjet financiare jobankare dhe mbikëqyrjen e tyre; me nxitjen e qëndrueshmërisë së sektorit financiar jobankar dhe me vetë

zhvillimin e konsolidimin e Autoritetit në veprimtarinë kërkimore përfshihet çdo punonjës i Autoritetit si edhe mund të përfshihen specialistë / akademikë / individë të jashtëm.

## **Neni 6**

### **Drejtimi i veprimtarinë kërkimore**

Veprimtaria kërkimore në Autoritet organizohet dhe drejtohet nga Departamenti i Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve. Puna kërkimore kalon në këto faza: planifikimi, zhvillimi, shqyrtimi dhe publikimi.

## **Neni 7**

### **Planifikimi**

1. Në muajin nëntor të çdo viti drejtori i Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve përgatit planin për punën kërkimore. Në përgatitjen e planit drejtori:
  - a. Komunikon me të gjitha njësitë e tjera të Autoritetit për të marrë propozime mbi tema të mundshme të punës kërkimore dhe angazhimin e punonjësve në këtë proces;
  - b. Përgatit listën e temave për punë kërkimore si dhe numrin e materialeve të diskutimit dhe/ose të artikujve për t'u përgatitur;
  - c. Propozon burimet njerëzore të brendshme dhe të jashtme që do të angazhohen në procesin kërkimor;
  - d. Propozon kohën e përfundimit të punës kërkimore;
  - e. Vlerëson burimet e nevojshme financiare për zhvillimin dhe publikimin e punës kërkimore;
  - f. Paraqet për miratim planin e punës kërkimore tek Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv brenda muajit dhjetor të çdo viti, të paktën për vitin pasardhës.
2. Pas miratimit të planit, drejtori i Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve njofton punonjësit për detyrat e përcaktuara në kuadër të zhvillimit të punës kërkimore si dhe kërkon nisjen e procedurave për kontraktimin apo blerjen e shërbimeve dhe produkteve që mbështesin punën kërkimore.
3. Plani i veprimtarisë kërkimore është pjesë e veçantë e planit vjetor dhe/ose atij afatmesëm të Autoritetit.

## **Neni 8**

### **Zhvillimi**

Gjatë fazës të zhvillimit të punës kërkimore punonjësi raporton, sipas një plani individual të miratuar nga drejtori i Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve, për ecurinë, problemet dhe nevojat që mund të dalin. Raportimi gjatë kësaj faze

bëhet edhe tek eprori përkatës për punonjësit e tjerë të Autoritetit të angazhuar në punë kërkimore.

## **Neni 9**

### **Shqyrtimi**

Produkti i punës kërkimore i nënshtrohet procesit të shqyrtimit të cilësisë së tij, sipas hapave të mëposhtme:

- a. Materiali shpërndahet për komente dhe diskutim tek punonjës të Autoritetit detyrat e të cilëve lidhen me çështjen e studiuar ose profili profesional dhe formimi i tyre vlerësohet i përshtatshëm;
- b. Materiali prezantohet në një takim diskutimi me grupin e mësipërm të punonjësve në prani të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv;
- c. Drejtori i Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve përcakton grupin e diskutimit në bashkëpunim me punonjës/in/t e angazhuar në punën kërkimore;
- d. Materiali pasi është diskutuar dhe ka trajtuar komentet e vlefshme, paraqitet për shqyrtim tek Bordi i Kërkimeve;
- e. Materiali pasi është diskutuar dhe ka trajtuar komentet e vlefshme të Bordit të Kërkimeve, me miratim të këtij të fundit, i paraqitet Bordit të Autoritetit për informim.

## **Neni 10**

### **Publikimi**

Produkti i punës kërkimore, pas informimit të Bordit të Autoritetit, publikohet në format e mëposhtme:

- a. Materiali publikohet i plotë tek faqja e internetit e Autoritetit, në rubrikën “puna kërkimore”, sipas ndarjes së detyrave për publikimin në internet;
- b. Materiali publikohet i plotë në një numër të kufizuar broshurash, të cilat numërohen në formatin “*numri i materialit (numri nga fillimi)/muaji/viti*”, duke zbatuar procedurat përkatëse në fuqi për përgatitjen e botimeve;
- c. Materiali publikohet në formën e një artikulli të shkurtër përshkrues për çështjen që trajton tek periodiku i Autoritetit;
- d. Publikime të tjera në media në formë artikujsh, intervistash, prezantime me punonjës të Autoritetit, prezantime apo leksione me studentë, paraqitje në konferenca e seminare apo çdo forme tjetër propagandimi me synim zgjerimin e njohjes së kësaj çështjeje nga publiku jo profesionist, sipas planit të përgatitur nga Drejtori i Drejtorisë së Kërkimeve dhe Zhvillimeve Strategjike.

## **Neni 11**

### **Bordi Kërkimor**

1. Autoriteti krijon Bordin kërkimor, i cili ka për detyrë shqyrtimin e cilësisë së punës kërkimore që kryhet në Autoritet. Bordi kërkimor përbëhet nga:
  - a. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv;
  - b. Nëndrejtori Ekzekutiv;
  - c. Drejtori i Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve;
  - d. Ekspertë të jashtëm të fushës akademike.
2. Bordi kërkimor mblidhet sa herë lind e nevojshme për shqyrtimin e cilësisë së punës kërkimore, me njoftim të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.
3. Bordi kërkimor funksionon në bazë të rregullave, të cilat propozohen nga Bordi kërkimor dhe miratohen nga Bordi i Autoritetit si shtojcë e kësaj Rregulloreje.

## **Neni 12**

### **Eksperti i jashtëm**

1. Eksperti i jashtëm, anëtar i Bordit Kërkimor, duhet në minimum të përmbushë kriteret si në vijim:
  - a. Të jetë person i dalluar për kontribut akademik, shkencor e kërkimor;
  - b. Të ketë fushën e ekspertizës dhe të punës kërkimore individuale të lidhur me fushat kërkimore të Autoritetit ose me çështjen për të cilën Autoriteti ka interes të studiohet;
  - c. Të ketë angazhim në fushën e akademike, të kërkimit, të prezantimeve në konferenca e aktivitete të ngjashme dhe të botimeve prej të paktën 5 vjetësh.
2. Eksperti i jashtëm, pjesëtar i punës kërkimore, duhet në minimum të përmbushë kriteret si në vijim:
  - a. Të jetë i dalluar për kontribut akademik, shkencor e kërkimor;
  - b. Të ketë fushën e ekspertizës dhe të punës kërkimore të lidhur me fushat kërkimore të Autoritetit ose me çështjen për të cilën autoriteti ka interes të studiohet.
3. Eksperti i jashtëm, anëtar i Bordit Kërkimor apo pjesëtar i punës kërkimore, përzgjidhet sipas procedurave ligjore në fuqi të kontraktimit të shërbimeve.

### **Neni 13**

#### **Trajtimi i personit të angazhuar në procesin kërkimor**

1. Eksperti i jashtëm, anëtar i Bordit Kërkimor apo pjesëtar i punës kërkimore, përfiton pagesë për shërbimin e kryer, duke iu referuar tarifave përkatëse të tregut.
2. Punonjësi i Autoritetit, pjesëtar i punës kërkimore, trajtohet sipas dispozitave të parashikuara në nenin 5/3 dhe nenin 7/2 të Rregullores “Mbi marrëdhëniet financiare të punonjësve me Autoritetin”, miratuar me vendim Bordi nr. 83, datë 29.06.2011, e ndryshuar.
3. Punonjësi i Autoritetit, pjesëtar i punës kërkimore, vlerësohet për punën kërkimore duke e pasqyruar në vlerësimin vjetor të punës individuale të kryer nga eprori përkatës.

### **Neni 14**

#### **Kontrata me ekspertin e jashtëm**

Kontrata me ekspertin e jashtëm, anëtar të Bordit kërkimor, dhe ekspertin e jashtëm, pjesëtar i punës kërkimore, në minimum përmбан:

- a. Detyrimin e ekspertit të jashtëm për t’iu përgjigjur në kohë dhe me cilësi kërkesave të Autoritetit në lidhje me punën kërkimore;
- b. Detyrimin e ekspertit të jashtëm për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit ndaj të cilit ekspozohet gjatë punës kërkimore dhe të materialit kërkimor deri në publikimin e tij;
- c. Detyrimin e ekspertit të jashtëm për të përdorur mirë dhe me efikasitet burimet të cilat i vihen në dispozicion nga Autoriteti për procesin e punës kërkimore;
- d. Detyrimin e ekspertit të jashtëm për ruajtjen e të drejtave të Autoritetit mbi materialin kërkimor dhe zbatimin e rregullave në fuqi për të drejtën e autorit.

### **Neni 15**

#### **Të drejtat mbi përdorimin e materialit kërkimor**

1. Autoriteti rezervon të drejtat mbi përdorimin e materialit kërkimor, të përgatitur nga punonjësi i Autoritetit dhe/ose nga eksperti i jashtëm, pjesëtar i punës kërkimore. Materiali kërkimor publikohet i shoqëruar me shënimin: *“AMF rezervon të gjitha të drejtat. Jeni të lutur të citoni burimin sa herë që i referoheni këtij material.”*
2. Materiali kërkimor publikohet me emrat e autorëve të tij, të shoqëruar me shënimin: *“Pikëpamjet e shprehura në këtë Material Diskutimi janë të autorit (autorëve) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo politikën zyrtare të AMF-së”.*

3. Materiali kërkimor mund të publikohet i plotë apo i pjesshëm në periodikë të ndryshëm; të prezantohet në konferenca apo në seanca leksionesh e seminaresh nga autori / autorët, pasi më parë të jetë marrë miratimi nga Autoriteti.
4. Për marrjen e miratimit autorët paraqesin kërkesën me shkrim tek Drejtori i Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve. Kërkesa përmban në minimum:
  - a. Formën e përdorimit të materialit (prezantim, leksion, artikull etj.);
  - b. Aktivitetin apo periodikun ku do të përdoret materiali (konferencë, workshop, leksione, seminare, revistë etj.);
  - c. Pjesën e materialit që synohet të përdoret.
5. Drejtori i Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve përgatit opinionin dhe e paraqet për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, brenda 3 ditë pune nga marrja e kërkesës.
6. Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv i njoftohet kërkuesit brenda 5 ditë pune nga marrja e opinionit prej Drejtorit të Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve.

## **Neni 16**

### **Dispozita të fundit**

1. Departamenti i Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve merr masa për realizimin e procedurave për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm, anëtar të Bordit kërkimor.
2. Bordi Kërkimor paraqet në Bordin e Autoritetit rregulloren e funksionimit të tij brenda muajit shkurt 2012.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi në 1 janar të vitit 2012.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë,

**Elisabeta Gjoni**

**Kryetar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare**

*“SHTOJCA” A*

#### *Mbledhja e Bordit Kërkimor*

1. *Bordi Kërkimor mblidhet sipas nenit 11 të kësaj rregulloreje, por jo më pak se dy herë në vit.*
2. *Bordi Kërkimor thirret në mbledhje me njoftim me shkresë ose me anë të postës elektronike të Kryetarit të Autoritetit.*
3. *Njoftimi për mbledhje bëhet të paktën 14 ditë përpara mbajtjes së mbledhjes dhe në të përmbahet vendi dhe ora e takimit si edhe materialet që do të jenë objekt I shqyrtimit nga ana e Bordit Kërkimor.*
4. *Mbledhja e Bordit Kërkimor kryhet kur të gjithë anëtarët janë të pranishëm.*
5. *Mbledhja e Bordit Kërkimor drejtohet nga Kryetari dhe përmban këta faza:*
  - ***Prezantimi i materialit:*** Autori apo autorët e materialit objekt shqyrtimi paraqesin në mënyrë të përmbledhur materialin duke shpjeguar metodën e punës, burimet e informacionit, qëllimin dhe konkluzionet.
  - ***Diskutimi i materialit:*** Autori apo autorët i përgjigjen pyetjeve të anëtarëve të Bordit Kërkimor. Më pas anëtarët e Bordit Kërkimor paraqesin vlerësimet dhe komentet e tyre për materialin kërkimor.
  - ***Vendimi:*** Në përfundim të diskutimit anëtarët e Bordit Kërkimor vendosin me konsensus për trajtimin e materialit duke miratuar kalimin për informim në Bordin e autoritetit ose duke kërkuar përpunim të mëtejshëm të tij dhe paraqitje në një afat tjetër.
  - ***Vlerësimi:*** Kur materiali vlerësohet i përshtatshëm për të informuar Bordin e Autoritetit, Bordi Kërkimor bën edhe klasifikimin përkatës të materialit, bazuar në shkallën e përputhshmërisë së materialit me objektivat strategjike të AMF-së dhe adresimin e çështjeve prioritare të institucionit. Mbi bazën e këtyre kriterëve, materiali klasifikohet nga nga 1 deri në 5, ku me 1 nënkuptohet që materiali vlerësohet se është plotësisht në përputhje me objektivat dhe prioritetin e problematikës së adresuar, ndërsa me 5 nënkuptohet që materiali vlerësohet se ka përputhshmëri të ulët.
6. *Bordi Kërkimor, në të paktën një mbledhje të tij, shqyrton dhe i propozon Kryetarit të Autoritetit:*
  - *Planin e punës kërkimore për vitin e ardhshëm;*
  - *Buxhetin mbështetës për punën kërkimore për vitin e ardhshëm;*
  - *Ekspertizën që mund të jetë e nevojshme të merret nga ekspertë të jashtëm për të mbështetur planin e punës kërkimore të propozuar.*
7. *Vendimi i mbledhjes së Bordit Kërkimor hartohet me shkrim dhe firmoset nga të gjithë anëtarët e tij.”*